

Drejtësia e Vonuar Ne Kosove

Author: IWPR

Kosova është një vakum ligjor, me ligje të papercaktuara, me gjykates që mungojnë dhe me gjykata të pajisura keq. Krimet nuk denohen, çeshtjet gjyqesore vonohen, dhe i gjithë kuadri ligjor është politizuar.

Pothuajse gjysëm viti pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, komuniteti nderkombëtar akoma nuk ka arritur të vendosë themelet e një sistemi juridik. Mungesa e fondeve, labirintet burokratike, rivalitetet ndërmjet institucioneve, dhe mungesa e një stafi të kualifikuar e kanë komplikuar edhe më tepër detyrën edhe ashtu të vështirë për të vendosur drejtësinë në një amjent pas lufte.

Vetëm një gjykatë rrethi funksionon, dhe ka perfunduar dy gjyqe. Shumica e krimeve - si venia e gjobave, rrembimet dhe vrasjet nuk denohen. Akoma nuk ka gjykata civile në Kosovë të cilat të gjykojnë çeshtjet jo kriminale. Elemente kriminale po hedhin rrenjë në disa pjesë të provincës, disa prej tyre të lidhur edhe me ish Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UCK).

Faji kryesor është i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili duhet të fillonte rindertimin e sistemit, që nga policia deri tek burgjet. Gjykatat janë pa materialet baze, gjykatesit pakohen tepër pak dhe jo rregullisht, dhe as edhe kopje të ligjeve të reja të përgatitura nga UNMIK nuk shpërndahen në të gjithë provincën atyre që duhet të zbatohen ato.

Një problem kyç është mungesa e dhenies së fondeve nga qeveritë perendimore. Por çeshtjet financiare nuk janë i vetmi problem.

"Jo çdo gjë ka nevojë për para," thotë Ethem Rugova, kryegjyqtari i gjykates së rrethit në Prizren i vendosur nga UNMIK. Problemi, thotë ai, është mungesa e stafit nderkombëtar të mireinformuar dhe ritmi i tyre i ngadalte.

"Ata vijnë këtu me paga të mira dhe nuk dëshirojnë të perfundojnë punën sepse kështu do të kthehen në vendet e tyre me shpejtë," thotë Rugova. "E si mund ta shpjegojë ndryshe punën e tyre të ngadalte?"

Marredheniet gjithnjë e më të acaruara ndërmjet juristëve lokal dhe UNMIK filluan me rregulloren e pare ligjore të nënshkruar nga Kouchner, mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

E nënshkruar më 25 Korrik, Rregullorja Nr. 1 thoshte se ligji "përpara 24 Mars 1999, do të vazhdojë të veprojë në Kosovë," për sa kohë që ai nuk bie në kundërshtim me standartet nderkombëtare të të drejtave të njeriut apo me rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara, e cila e vendos Kosovën nën protektoratin ushtarak dhe administrimin nderkombëtar.

Kombet e Bashkuara e interpretuan rregulloren në mënyrë të tillë që kodi penal Serb dhe kodi i procedurës penale Jugosllave, të cilat vepronin në Kosovë përpara fillimit të bombardimeve të NATO-s më 24 Mars, të vzhdonin të kishin fuqi vepruese.

Megjithatë interpretimi i UNMIK është konform rregullave nderkombëtare, mungesa e qartësisë në thenien e kesaj gjëje në fakt hap rrugën për juristet Shqiptare të Kosovës që ata të argumentojnë se UNMIK duhet të njohë kodin e vjetër penal që ka vepruar në Kosovë deri në 1989, kur është hequr autonomia e Kosovës.

Termi "perpara" sipas disa juristeve Shqiptare do te thote cdo periudhe perpara 24 Marsit. Dhe per ta, kodi Serb eshte vendosur ne menyre jo kushtetuese, me qellim diskriminimin e Shqiptareve dhe simbolizon nje dekada shtypje ndaj tyre.

Disa gjykates te emeruar rishtazi kercenuan se do te jepnin doreheqjen. Nje gjykates nga Prizreni, A. Krasniqi, tha se duke ushtruar ligjin Serb ne Kosove, UNMIK ne fakt "po legjitimonte pushtimin Serb te Kosoves."

Ceshtja u diskutua edhe ne nje takim te mbajtur me 15 Gusht ndermjet Kouchner dhe gjykatesve dhe prokuroreve te emeruar rishtazi. Ne kete mbledhje, Kouchner u perkul perpara kerkesave te mos perdorimit te ligjit Serb, duke kundërshtuar keshtu rregulloren e nxjerre prej tij. Eksperte ligjore thone se akoma edhe me e rendesishme eshte se ai i lejoi juristet Shqiptare te politizonin procesin juridik.

Ka ndryshime shume te vogla ndermjet kodit penal te Kosoves dhe atij Serb dhe edhe juristet Shqiptare e kane pranuar se ceshtja eshte thjesht simbolike dhe politike.

Deri sa te pergatiten kodet e reja te procedures penale - per te cilat mund te nevojiten muaj, konfuzioni rreth ligjeve te zbatueshem shkakton nje vakum ne sistemin ligjor te Kosoves.

Ne disa raste, ushtaret e KFOR dhe policia e UNMIK perdorin nje procedure ndersa gjykatat perdorin nje tjeter. Disa krime nuk perfshihen fare ne kodin e Kosoves, si per shembull krimet e luftes, keshtu qe edhe gjykatesit Shqiptare jane te detyruar te aplikojne ligjet Serbe apo Jugosllave.

Edhe nese arrihet nje konsensus mbi ligjin, gjykatat nuk mund te funksionojne normalisht. Deri ne mes te muajit Nentor, UNMIK kishte emeruar 41 gjykates dhe 14 prokurore per pese rrethet e Kosoves dhe nje Gjykate Ad Hoc per Apelin Perfundimtar. Por te shtate gjykatesit Serb te emeruar rishtazi dhane doreheqjen menjehere pas emerimit te tyre.

Gjykatesit dhe prokuroret qe mbeten jane 42 Shqiptare, kater Muslimane Sllav, nje eshte Rom, dhe nje Turk. Perpara luftes, Kosova kishte 650 gjykates dhe prokurore, megjithese pergjithesisht pranohet se ky numer ishte teper i madh.

Asnje prej ketyre te emeruarve nuk po punon ne kushte te pranueshme. Gjykatat dhe prokurorit kane mungesa baze si per shembull leter, per te mos permendur kompjuterat. Kur autoritetet Serbe u terhoqen nga Kosova ne Qershor, ata morren me vete cdo gje me vlere, perfshire edhe dosjet e gjykatave per dhjete vjetet e fundit.

Deri ne mes te Nentorit, UNMIK ka ofruar mbeshetje minimale per disa nga gjykatat e rretheve. Zyra e prokurorit ne Peje, ka nje makine shkrimi mekanike, asnje telefon dhe nje cati qe fut uje. Kryeprokurori i emeruar, Flamur Kelmendi, i cili eshte pushuar nga puna ne Peje se bashku me koleget e tij Shqiptare ne 1989, duhet te veproje ne nje zone me 450,000 banore te cilet kane uje dhe energji elektrike me raste.

Edhe me poshteruese eshte skema e pageses e vendosur nga UNMIK. Buxheti duhet te rishikohet ne Janar, thote UNMIK, duke parashikuar paga dhe kushte me te mira. Deri atehere, prokuroret dhe gjykatesit do te paguhen afersisht 350 marka ne muaj (180 dollare), dhe shumica e tyre e kane marre kete pagese vetem per dy muaj. Perndryshe, nje roje ne godinen e UNMIK ne Prishtine paguhet 1,100 marka.

Por shume probleme mund te zgjidhen edhe pa fonde te tjera. UNMIK akoma nuk ka nje gazete zyrtare, ku te botohen te gjitha rregulloret e Kouchner, duke vonuar keshtu shperndarjen e rregulloreve te reja me muaj. Rivaliteti institucional dhe pergjegjesite e perbashketa te OKB dhe Organizates per Siguri dhe

Bashkepunim ne Europe (OSBE), dy organizmat pergjegjes ne UNMIK per sistemin gjyqesor, i komplikojne edhe me tej gjerat.

Siguria pothuajse nuk ekziston ne gjykata. Gjykata e Prizrenit eshte vjedhur tre here, dhe ne nje nga dy gjyqet e bera deri me tani, familja e te akuzuarit per pak nuk shkaktoi nje perleshje kur u lexua vendimi i gjykates per 14 vjet burgim.

Deri ne mes te Nentorit, rreth 250 njerez ishin te arrestuar, ne burgjet ushtarake ne secilin nga pese sektoret e Kosoves. Qendrat ku mbahen te arrestuarit jane me mire se ato te qeverise Serbe, thone avokatet mbrojtës Shqiptare, dhe te arrestuarit vizitohen nga perfaqesues te Kryqit te Kuq dhe OSBE.

Por akoma nuk ka kushte te vecanta per te miturit dhe ata me shqetesime nervore.

Nga te arrestuarit, 14 vete akuzohen per krime lufte - tre nga te cilet Rome dhe pjesa tjeter Serb. Ne se ata do te gjykohen ne Kosove, dhe jo ne Hage, ka shqetesime serioze per te drejten e tyre per nje gjyq te ndershem. OSBE ka propozuar sjelljen e gjykatesve nderkombetare.

Deri me sot, 22 gjyqe penale kane filluar ne Prizren, e cila eshte e vetmja gjykate me numrin e kerkuar per nje gjyq. Rregullorja ligjore thote se personat nen hetim duhet te dalin perpara gjyqit brenda 6 muajve nga arrestimi i tyre dhe se policia e perfshire ne rastin e tyre duhet te deklaroje faktet perpara gjykatesit. Kjo do te jete teper e veshtire ne rastin e ushtareve te KFOR apo policeve te UNMIK te cilet jane transferuar jashte Kosoves perpara se nje rast te shkoje ne gjykate - edhe nje pengese tjeter qe do te vonoje drejtesine ne Kosove.

Fred Abrahams eshte nje studjues i vjeter i Ballkanit per Human Rights Watch. Raporti me i fundit per situaten ligjore ne Kosove nga Komiteti i Avokateve te Human Rights mund te gjehet ne

Location: [Balkans](#)
[Macedonia](#)
[Albania](#)
[Serbia](#)

Source URL: <https://iwpr.net/sq/global-voices/drejtesia-e-vonuar-ne-kosove>